



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:118262  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05635400

**C.nr.2076/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**—Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.Z., nga Komuna Pejë, të cilën e përfaqëson Fatmir Ademaj, avokat nga Peja, sipas autorizimit, kundër të paditurës Universiteti “Haxhi Zeka” me seli në Pejë, rr. ”UÇK”. p.nr, me bazë juridike kompensim mbi bazën e inflacionit, vlera e kontestit 723 euro, jashtë seance, me datë 29.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.Z., nga Komuna Pejë dhe **DETYROHET** e paditura Universiteti Publik “Haxhi Zeka”, me seli në Pejë, që paditëses, në emër të kompensimit për inflacion për periudhën kohore nga data 06.03.2020 e deri më 21.11.2022, t’ia paguajë shumën prej 723 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data e ushtrimit të padisë (25.05.2023), e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

**II. DETYROHET** e paditura Universiteti Publik “Haxhi Zeka”, Komuna Pejë, që paditëses M.Z., nga Komuna Pejë, në emër të shpenzimeve të procedurës të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

**A r s y e t i m**

Paditësja M.Z., përmes të autorizuarit të saj, me datë 25.05.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurës Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, me bazë juridike kompensim mbi bazën e inflacionit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, që paditëses t’ia paguajë në emër të kompensimit për inflacion, shumën prej 723.00 euro, për periudhën kohore nga data 06.03.2020 e deri më datën 21.11.2022, me kamat ligjore prej 8 % në vit nga data e ushtrimit të padisë. Tutje ka shtuar se paditësja është në marrëdhënie pune në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe datës 22.01.2021 është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja

e inflacionit të futet në pagë. Në bazë të Entit të statistikave të Kosovës, në publikimin e inflacionit vërtetohet se shkalla e inflacionit në vend ka qenë, për vitin 2020 mesatarja ka qenë 0.2%, për vitin 2021 mesatarja ka qenë 3.4 %, mesatarja e inflacionit nga muaji Janar 2022 e deri në fund të muajit Nëntor 2022 ka qenë 11.5 %.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 22.04.2024, pranë kësaj gjykate ka paraqitur përgjigje në padi, duke theksuar se sa i përket përfshirjes së përqindjes së inflacionit në pagë, kjo e drejtë nuk i takon, pasi që paga, shtesat dhe të gjitha benifitet tjera për shërbyesit civil janë të parapara në Ligjin nr.03/L-149, për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës dhe rregullore nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil. Padiçësja, kundërshtimin e bazës ligjore për këtë padi e bazën në faktin se, i punësuar gjatë periudhës së kërkuar për shujtë, ka qenë i punësuar në bazë të Ligjit për Shërbyesit Civil (tani shfuqizuar) prandaj të gjithë të punësuarit me bazë nga Ligji për Shërbyesit Civil, nuk janë paraparë në kontratën kolektive të vitit 2017. Shërbyesit civil pagat dhe të gjitha shtesat e tjera i kanë të rregulluara me ligjin 03/L-147 për pagat e nëpunësve civil (tani i shfuqizuar). Po ashtu, shtesat në pagë dhe kompensimet e tjera të nëpunësve civil janë të rregulluara me rregulloren nr.33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensimet të tjera të nëpunësve civil, qëllimi i të cilës ka qenë “Kjo rregullore përcakton kushtet dhe procedurat për shtesat, kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civil”, ndërsa fushëveprimi “Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me shtesat dhe kompensimet mbi pagën bazë të nëpunësve civilë”. Sa i përket kontratës kolektive e cila është marr si baze për këtë çështje e njëjta nuk është akt ligjorë, apo nënligjor në bazë të të cilit funksionon puna brenda Universitetit dhe nuk e obligon Universitetin të kryej një kompensim të tillë, siç kërkohet nga kërkesëpadija e padiçësve. Nënshkrues të kësaj kontrate ashtu siç është e ditur për të gjithë, është MASHT dhe SBASHK. Në nenin 46 par.1 i kësaj kontrate specifikon se MASHT dhe SBASHK angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafi 5, 7, dhe 9. Ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht me Ministrin e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunat e Republikës së Kosovës më qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenin 35 paragrafi 5, 7 dhe 9, brenda mundësive financiare institucionale, ligjore dhe financiare. Duam të theksojmë se Ministria e Arsimit dhe SBASHK, kanë dështuar në përmbushjen e detyrës së tyre, siç është paraparë në nenin 46 të kontratës kolektive. Konkretisht, detyrimi për të siguruar dhe ndarë mjete financiare për institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, për realizimin e buxhetit të nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kontratës kolektive, nuk është zbatuar. Për më tepër, mungesa e përgjegjësisë në përmbushjen e detyrave të parapara në kontratën kolektive reflekton një mungesë serioze të respektimit të përgjegjësive dhe angazhimeve të autoriteteve përgjegjëse ndaj institucioneve arsimore. Në këtë kontekst, ne e argumentojmë se është e padrejtë që institucionet arsimore, si Universiteti ynë, të detyrohen të zbatojnë dispozitat e kontratës kolektive kur autoritetet përkatëse nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre themelore të parapara në këtë marrëveshje. Nga ky nen vërtetohet fakti se në asnjë pikë nuk përmenden Universitetet publike dhe asnjë nga palët nënshkruese të

kësaj kontrate nuk përfaqëson Universitetin tonë. Asnjë nga të lartcekurit nuk është angazhuar, planifikuar apo ndarë buxhet për universitetit për të implementuar pikën 7 të nenit 35. Po ashtu neni 2 i kësaj kontrate rregullon zbatimin e sajë, e cila në paragrafin 1, pika 1.1 thotë që dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme ndër të tjera edhe për institucionet e arsimit të lartë në mbare territorin e Republikës së Kosovës të cilët janë anëtar të SBASHK-ut, gjë e cila nuk është vërtetuar se të punësuarit në universitet janë anëtar të SBASHK - ut. Mbi këtë baze ligjore vërtetohet fakti se as kërkesëpadia nuk është e argumentuar mirë dhe nuk ka pasur baze ligjore për tu kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe duhet aprovuar në tërësi.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, andaj, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit ta kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, po ashtu mbështetur në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, e që nga deklarimet e palëve, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer.

Gjatë vlerësimit dhe analizimit të pretendimeve të paraqitura nga palët ndërgjyqëse me padi, përgjigje në padi dhe provat, gjykata ka gjetur se paditësja ishte në marrëdhënie pune tek e paditura gjatë periudhës për të cilën kërkon kompensimin në emër të inflacionit, e ky fakt vërtetohet edhe nga Kontrata e punës me numër 2822, e lëshuar nga Universiteti “Haxhi Zeka”, ku në përmbajtje të saj vërtetohet edhe fakti se paditësja për periudhën që ka kërkuar kompensimin gëzon pagë prej 460.20 (katërqind e gjashtëdhjetë) euro. Provës të lartcekura gjykata ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e saj, nga e cila gjykata vërtetoi se paditësja gjatë periudhës për të cilën kërkon kompensimin në emër të inflacionit ka qenë në marrëdhënie tek e paditura dhe vërtetoi lartësinë e pagës të cilën e gëzonte paditësja, këto dy fakte të rëndësishme nuk ishin konteste as nga pala e paditur nga

pretendimet e saj të dhëna në përgjigje padi. Po ashtu bazuar në nenin 329 paragrafi 1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, e që në rastin konkret kontrata e punës ishte e përpiluar nga vetë pala e paditur.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadiës, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës me numër 01-02-1436, të datës 27.10.2023, sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjen e inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga viti 2020 deri në vitin 2022 (brenda kërkesës së paditëses) sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën Mars-Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.20%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditëses e cila në vitin 2020 ka qenë 460.20 euro, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të i njohët në pagën bazë për periudhën 10 mujore në total të jetë 9.20 euro, apo 0.92 euro për muaj ( $460.20 \times 0.2\% \times 10 = 9.20$ ).

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.40%, andaj duke e llogaritur pagën e paditëses e cila në vitin 2021, ishte 460.20 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të i njohët në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 187.76 euro, apo 15.64 euro për muaj ( $460.20 \times 3.4\% \times 12 = 187.76$ ).

- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.60%, mirëpo kërkesa e palës paditëse ka qenë 10.40%, andaj duke e llogaritur pagën e paditëses e cila në vitin 2022, ishte 460.20 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të i njohët në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 526.46 euro, apo 47.86 euro për muaj ( $460.20 \times 10.4\% \times 11 = 526.46$ ).

Gjykata ka pasur parasysh se në vitin 2022 shkalla e inflacionit ka qenë 11.60 %, mirëpo gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke ja njohur shumën ashtu siç e ka kërkuar paditësja me 10.40 %, dhe po ashtu sipas kalkulimit për të gjitha vitet ( $9.20 + 187.76 + 526.46$ ) del shuma prej 723.42, mirëpo duke pasur parasysh se kërkesa e palës paditëse është në shumë prej 723.00 euro, gjykata ka vendosur duke u bazuar në Ligjin e Procedurës Kontestimore nga neni 2 parag.1 të LPK-së, është paraparë shprehimisht se në procedurën kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave, që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse, si në pikë I të dispozitivit të këto aktgjykimi.

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune për periudhën që kërkon kompensimin dhe se në periudhën 06.03.2020 deri me datë 21.11.2022 në pagën e paditëses nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar bazën ligjore, gjykata e vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiës, mirëpo baza e

kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës në nenin 90 të Ligjit të Punës i cili përcakton: “1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes. 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës”, ndërsa neni 90 pika 6 përcakton : “6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuara në këtë ligj.”. Pra me Marrëveshje Kolektive mund të parashihen beneficione dhe të drejta më tepër se sa i parashihet ligji, por jo të drejta më të pakta pasi Ligji përcakton minimumin apo kufirin minimal.

Ndërsa sa i përket pretendimit të paditurës, se Kontrata Kolektive nuk është akt ligjor apo nënligjor në të cilën funksionon puna brenda Universitetit dhe nuk e obligon Universitetin të kryej kompensime të tilla, një pretendim të tillë nuk qëndron për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen, pasi që bazuar në Neni 2 [Zbatimi i kontratës] i Kontratës Kolektive të Kosovës, parashihet: pika 1.1. “Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”, pika 1.2 “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DICA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Po ashtu vlen të ceket se në përmbajtje të kontratës së punës e lidhur në mes të punëmarrëses (paditëses) dhe punëdhënëses (paditurës), përmes nenit 18 është shprehur vullneti i palëve kontraktuese si në vijim: Neni 18 par.1 “Në asnjë rast, dispozitat e kësaj Kontrate nuk mund të jenë më pakë të favorshme për të punësuarit dhe punëdhënësit, se dispozitat e Ligjit të Punës, Kontratës Kolektive ose të Akteve të Brendshme të Punëdhënësit, për sa u përket të drejtave dhe kushteve nga marrëdhënia juridike e punës”, par.2 “ Për të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë përcaktuar me këtë Kontratë, do të zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës, Kontratës Kolektive dhe dispozitat e Akteve të Brendshme, pra në vlerësim të cituarave më lartë, rrjedhë se kjo detyrim i paditurës është dhe detyrim kontraktual e lidhur mes palëve.

Nuk qëndron as pretendimi i palës paditur se me nenin 46 paragrafi 2 të Marrëveshjes i cili ka përcaktuar se palët nënshkruese në rastin konkret Ministria dhe SBASHK-u angazhohen bashkërisht me Ministrinë e Financave për sigurimin e mjeteve financiare për Komunat e Republikës së Kosovës me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm, pasi që kjo dispozitë asesi nuk e liron nga detyrimi të paditurën në përmbushjen e detyrimit, por SBASHK-u si

përfaqësues i punëtorëve dhe Ministria e Arsimit, që nga nënshkrimi i marrëveshjes angazhohen bashkërisht, por se detyrimi si detyrim mbetet, dhe kjo asesi nuk paraqet pengesë për paditësen apo personat e tjerë që të kërkojnë të drejtat e tyre që iu garantohen me këtë Marrëveshje.

Gjykata lidhur me kamatën ka vendosur duke u bazuar në nenin 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe tarifës së OAK-së, ku lartësia e shpenzimeve iu referohen shumave si për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro si dhe taksa për padi shumë prej 20 euro, e gjithsejtë shumë prej 124 euro.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 398 e lidhur me nenin 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.2076/23, me datë 29.04.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.